



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më . . . 2024

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS - “ F.V kaldaja me ngrohje pelet”

LLOJI PROCEDURËS - “Procedurë e hapur – Mallra”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 44621200-1 – Kaldaja

VLERA E FONDIT LIMIT - 5.166.660 (pesëmilion e njëqind e gjashtëdhjete e gjashtëmije e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) **lekë pa t.v.sh..**

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si mëposhte:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajnë listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 8;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqese kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete **jo me e vogel se vlera e fondit limit** te prokuruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet te kete paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri **2.2.3** eshte vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP sidhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Vendosija e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar qe operatorët ekonomikë nuk kane pagesa te pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vleres se perlloritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) **Ne rastin e përvijes se meparshme te realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku te jene shenuar sakte datat, shumet, sasite e mallrave te furnizuara,

ose

b) **Në rast se përvija e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku te jene shenuar sakte datat, shumet dhe sasite e mallrave te furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvijën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te disponojë **nje mjet te pershatshem kamionçine për transport** për transportin e mallit objekt prokurimi, per te cilin duhet te paraqese dokumentat e meposhtem:

- ***Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;***

ose

- ***Kontratën noteriale te marrjes me qira të mjetit***, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vete ose të trete per ato mjete qe pajisen me leje transporti sipas legjislacionit ne fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjetit, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. *Mjeti i mësipërm kërkohet, duke u bazuar në planim e shpërndarjes për arsye se furnizimi eshte ditor edhe në orë të përcaktuar për të gjithë objektet arsimore sipas grafikut si dhe shtrirjes gjeografike të këtyre institucioneve ne territorin e Bashkise Elbasan (qytet).*

2.3.3 Ne rast se operatori ekonomik ofertues nuk eshte prodhues, ai duhet te paraqese kontratë furnizimi materiale/autorizim nga prodhuesi ose distributor zyrtar per mallin objekt prokurimi shoqeruar me katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku te dallohen qarte specifikimet teknike te mallit. Ne rastin e kontrates se furnizimit/autorizimit me distributorin te dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin. Kontrata/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme nga Autoriteti Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6 b), pikën 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i jep garanci autoritetit kontraktor se operatori ekonomik ka kapacitete dhe do të ofrojë produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallit objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe te paraqese çertifikaten e vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit te Cilesise” ose ekuivalente, e vlefshme dhe të perputhet me mallin objekt prokurimi.

Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Kriteri 2.3.4 eshte vendosur ne perputhje me Nenin 40 pika 6 germa c te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar ne nenin 44 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar ne nenin 79 te LPP.

Ky kriter eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikaten e menaxhimit te cilesise gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te AK qe ky OE do te ofertoje produkte te certifikuara te nje cilesie te mire e ne perputhje me standartet nderkombetare te cilesise.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” , i ndryshuar dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike janë hartuar nga Qendra Ekonomike e Arsimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJESIA E PROKURIMIT